



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.2024

Shtojca 13

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT 2
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data _____ .2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “AIDA CONSTRUCTION” SHPK, **Adresa:** Fier, Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Punë (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca: **REF-10871-06-24-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **7,833,332.46** (shtatë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 35 ditë / (5 jave).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.34, datë 01.07.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se, Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**AIDA CONSTRUCTION**” SHPK, me numër NIPTI **M03116403L**.
Vlera e ofertuar: 6,085,751 (gjashtë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë **pa TVSH**.
2. Operatori ekonomik “**SHENDELLI**” SHPK, me numër NIPTI **K07924803N**.
Vlera e ofertuar: 6,406,857 (gjashtë milion e katërqind e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik “**MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE**” SHPK, me numër NIPTI **K81314023A**.
Vlera e ofertuar: 6,407,018.57 (gjashtë milion e katërqind e shtatë mijë e tetëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik “**GLAVENICA**” SHPK, me numër NIPTI **K17710805A**.
Vlera e ofertuar: 6,533,421 (gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e një) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik “**ERAL CONSTRUCTION COMPANY**” SHPK, me numër NIPTI **K82230002K**.
Vlera e ofertuar: 7,040,426 (shtatë milion e dyzet mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë **pa TVSH**.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**SHENDELLI**” SHPK, me numër NIPTI **K07924803N**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.3.4/e të DST, përkatësisht:

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

e. **Bojaxhi 3 (tre)**, per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, Çertifikatë ose Deshmi Kualifimi e Sigurimit Teknik si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi muajn e fundit te deklaruar.

KVO konstatoi se: OE “SHENDELLI” SHPK nuk ka deklaruar 1 Bojaxhi, kërkesë kjo e përcaktuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Sqarojmë se KVO, pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatoi se OE ka deklaruar 2 (dy) bojaxhi, ndërsa AK në DST ka kërkuar 3 (tre) bojaxhi.

2. OE nuk plotëson pikën 2.3.8 të DST, përkatësisht:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjet transporti (3-5 ton) 2 cope

KVO konstatoi se: OE “SHENDELLI” SHPK nuk ka deklaruar 1 Automjet transporti (3-5 ton), kërkesë kjo e përcaktuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Sqarojmë se KVO, pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatoi se OE ka deklaruar 1 (një) Automjet transporti (3-5 ton), ndërsa AK në DST ka kërkuar 2 (dy) Automjet transporti (3-5 ton).

3. OE nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

KVO konstatoi se: OE “SHENDELLI” SHPK nuk ka paraqitur grafikun e punimeve, kërkesë kjo e përcaktuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**AIDA CONSTRUCTION**” SHPK, me adresë: Fier, Rr BRIGADA XI SULMUESE, LAGJIA APOLONIA, pallati ne krah te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, 9301, Bashkia Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **6,085,751** (gjashtë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **6,407,018.57** (gjashtë milion e katërqind e

shtatë mijë e tetëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

JO (Nuk ka patur)

**Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA**